

Zgjedhje të parakohshme
parlamentare gjatë verës?
Baraliu komenton situatën
politike I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja I BËN THIRRJE KOSOVËS T'I DËGJOJË KËSHILLAT E PARTNERËVE TË SAJ MË TË AFËRT I FAQE 3



Zëvendësndihmësja e sekretarit amerikan të Shtetit në Byronë për Demokraci, të Drejtë të Njeriut dhe Punë, Nicole Chulick, tha se është e rëndësishme që Kosova të bashkëpunojë me partnerët e

saj për ta forcuar kandidaturën për anëtarësim në të gjitha institucionet euroatlantike ashtu si edhe në Këshillin e Evropës. "Ne i bëjmë thirrje Kosovës t'i dëgjojë këshillat e partnerëve të saj më të afërt në

mënyrë që të garantojë një rezultat pozitiv kur del në një votim", ka theksuar Chulick gjatë një takimi të martën me një grup gazetarësh në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë

PRANIMI NË KIE "MUND TA KETË FATIN SI LIBERALIZIMI I VIZAVE" F. 4



MBAHET TAKIMI PËR SISTEMIN E ARSIMIT
DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL, DISKUTOHET
ME DONATORË KRYESORË F. 7

AKTUALE



FRANCA DHE BELGIKA PËRKRAHIN
KËRKESËN PËR FLETARRESTIME NDAJ
LIDERËVE TË IZRAELIT DHE HAMASIT F. 2

EDITA TAHIRI: NË VEND SE TË ISHTE
KRYEMINISTËR I LEKUT, KURTI PO
BËHET 'KRYEMINISTËR I DINARIT' F. 5

ARRATISJA E ENVER SEKIRAOËS,
KURTI THOTË SE KA DËSHTUAR
SISTEMI GJYQËSOR F. 7

EKONOMI



SHBA-ja KRITIKON ASHPËR
MBYLLJEN E DEGËVE TË BANKËS
SERBE NË VERI TË KOSOVËS F. 8

8.5 MILIONË EURO SUBVENCION PËR
SEKTORIN E BLETARISË F. 8

SPORT



BALLKANI KËRKON TROFEUN
E PARË TË KUPËS, PRISHTINA
DALJEN NË EVROPË F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH: Mbi 14 000 të zhvendosur nga luftimet në Harkiv

GJENEVË, 21 MAJ - Më shumë se 14 000 persona janë zhvendosur ditët e fundit nga rajoni lindor ukrainas i Harkivit, ku Rusia më 10 maj nisi një ofensivë tokësore, tha Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Gjatë kësaj ofensive forcat ruse kanë bërë përparimin më të madh në Ukrainë në të paktën 18 muaj. “Gjatë dy javëve të fundit luftimet në rajonin e Harkivit në Ukrainë janë përshkallëzuar rëndë”, tha në një konferencë për medie përmes video-lidhjes përfaqësuesi i OBSH-së në

Ukrainë, Jarno Habicht.

“Më shumë se 14 000 persona janë zhvendosur brenda ditësh dhe pothuajse 189 000 ende gjenden brenda perimetrit prej 25 kilometrash në kufi me Federatën Ruse, duke u përballur me rreze të mëdha për shkak të luftimeve që po vazhdojnë”, shtoi ai.

Habicht tha se agjencia e Kombeve të Bashkuara për shëndetësi i ka siguruar këto shifra pas bisedave që ka zhvilluar me autoritetet lokale. “Me përkeqësimin e situatës së

sigurisë po rriten nevojat humanitare në rajon”, theksoi ai. Konflikti në Harkiv “ka rritur ndjeshëm numrin e pacientëve të plagosur”, shtoi ai.

Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Sipas OBSH-së, që nga nisja e luftës janë kryer më shumë se 20 000 amputime. Habicht tha se mesatarisht në vit, 200 autoambulanca janë dëmtuar apo shkatërruar nga granatimet “duke u mohuar ukrainasve kujdesin urgjent shëndetësor”.



Franca dhe Belgjika përkrahin kërkesën për fletarrestime ndaj liderëve të Izraelit dhe Hamasit

HAGË, 21 MAJ - Franca dhe Belgjika kanë thënë të martën se e mbështesin kërkesën e kryeprokurorit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP) për lëshimin e fletarrestimeve për liderët e Izraelit dhe Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Ministria e Jashtme e Francës tha se e “mbështet Gjykatën Ndërkombëtare Penale, pavarësinë e saj, dhe luftën kundër mosndëshkueshmërisë në të gjitha situatat”. “Krimet e kryera në Gazë duhet të ndiqen penalisht patjetër në nivelet më të larta, pavarësisht se kush është kryerësi”, tha ministria e Jashtme e Belgjikës, Hadja Lahbib.

Kryeprokurori i GJNP-së, Karim Khan, tha të hënën se beson se Netanyahu, ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, dhe tre liderë të Hamasit - Yehia Sinwar, Mohammed Deif dhe Ismail



Haniyeh - janë përgjegjës për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit në Rripin e Gazës dhe në Izrael, së paku nga 7 tetori 2023.

Si Izraeli, ashtu edhe Hamasi, e kanë dënuar kërkesën e Khanit për fletarrestime kundër liderëve të tyre.

Ndërkohë, presidenti amerikan Joe Biden e denoncoi kërkesën e

kryeprokurorit për ta arrestuar Netanyahu dhe Gallantin, duke thënë se “çfarëdo që ka dashur të thotë prokurori, nuk ka asnjë paralelizëm mes Izraelit dhe Hamasit”.

Prokurori duhet ta kërkojë lëshimin e fletarrestimeve nga një panel prej tre gjyqtarësh, të cilëve mund t'u duhen deri në dy muaj kohë për t'i shqyrtuar provat dhe

për të vendosur nëse mund të procedohet.

Zëdhënësi i GJNP-së, Fadi Al-Abdallah, i tha “Radios Evropa e Lirë” se gjykatësit do të “marrin vendimin e tyre brenda afateve”, por nuk specifikoi ndonjë datë.

Të martën më herët forcat izraelite e kryen një operacion kundër një bastioni militant në Bregun e uzurpuar Perëndimor,

duke i vrarë së paku shtatë palestinezë, përfshirë një mjek, sipas autoriteteve lokale.

Ushtria izraelite tha se forcat e saj goditën militantët gjatë një operacioni në Xhenin, një qytet në veri të Bregut Perëndimor. Ky qytet, së bashku me një kamp refugjatësh ngjitur, kanë qenë për kohë të gjatë bastion i luftës së armatosur kundër Izraelit.

Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi të Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë.

Lufta izraelite i ka vrarë më shumë se 35 000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve të Hamasit.

Por, lufta izraelite ka shkaktuar edhe krizë humanitare në Gazë, duke bërë që rreth 80 për qind e popullsisë të zhvendoset dhe qindra mijëra njerëz të vuajnë nga uria, sipas zyrtarëve të OKB-së.

Irani nis ceremonitë e varrimit për presidentin dhe ministrin e Jashtëm

TEHRAN, 21 MAJ - Disa ceremoni varrimi janë duke u zhvilluar në Iran më 21 maj, për vdekjen e presidentit Ebrahim Raisi, ministrit të Jashtëm Hossein Amir-Abdollahian dhe të tjerëve që humbën jetën nga rrëzimi i një helikopteri në fundjavë.

Lideri suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, i shpalli pesë ditë zie të hënën.

Në Tabriz, kryeqytetin e Provincës Azerbajxhani Lindor të Iranit, ku u rrëzua helikopteri më 19 maj, mijëra njerëz morën pjesë në një ceremoni në kujtim të të vdekurve.

Ndërkohë, agjencia shtetërore e lajmeve, IRNA, e postoi në rrjetin social X fotografinë e parë që shfaq arkivolet e Raisit dhe Amir-

Abdollahianit.

Autoritetet iraniane i kanë caktuar edhe disa ceremoni të tjera për Raisin. Një e tillë është caktuar për të martën pasdite në qytetin Qom.

Ceremoni të tjera do të mbahen në Teheran dhe Birjand më 22 dhe 23 maj, kur Raisi do të varroset në faltoren Imam Reza në qytetin e shenjtë Mashhad, raportuan mediet iraniane.

Khamenei e emëroi Mohammad Mokhberin, i cili shërbeu si zëvendës-president i Raisit, në detyrën e presidentit të përkohshëm.

Koha e tij si president do të jetë e shkurtër, pasi autoritetet kanë caktuar 22 qershorin si datë për mbajtjen e zgjedhjeve të reja

presidenciale.

Mokhber, së bashku me kryetarin e Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, dhe kryetarin e Gjyqësorit, Gholamhossein Mohseni-Ejei, do t'i organizojnë zgjedhjet e reja.

Zëvendësministri i Jashtëm, Ali Baqeri Kani, u emërua ministër i Jashtëm në detyrë, sipas medieve iraniane.

Pasi televizioni shtetëror iranian raportoi më 20 maj se helikopteri ishte rrëzuar për shkak të motit të lig, ekipet për kërkim dhe shpëtim i gjetën trupat e Raisit dhe Amir-Abdollahian në vendin e ngjarjes në veriperëndim të Iranit.

Komunikimi kishte humbur derisa helikopteri po kthehej në



Tabriz, pasi Raisi kishte marrë pjesë në përrurimin e një dige me homologun e vet azerbajxhanas, Ilham Aliyev, në kufirin e tyre të përbashkët.

IRNA raportoi se të gjithë tetë njerëzit në bordin e helikopterit, të cilin Irani e kishte blerë në fillim të viteve 2000, humbën jetën.

ShBA-ja i bën thirrje Kosovës t'i dëgjojë këshillat e partnerëve të saj më të afërt



Zëvendësndihmësja e sekretarit amerikan të Shtetit në Byronë për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, Nicole Chulick, tha se është e rëndësishme që Kosova të bashkëpunojë me partnerët e saj për ta forcuar kandidaturën për anëtarësim në të gjitha institucionet euroatlantike ashtu si edhe në Këshillin e Evropës. “Ne i bëjmë thirrje Kosovës t’i dëgjojë këshillat e partnerëve të saj më të afërt në mënyrë që të garantojë një rezultat pozitiv kur del në një votim”, ka theksuar Chulick gjatë një takimi të martën me një grup gazetarësh në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë

PRISHTINË, 21 MAJ - Zëvendësndihmësja e sekretarit amerikan të Shtetit në Byronë për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, Nicole Chulick, tha se është e rëndësishme që Kosova të bashkëpunojë me partnerët e saj për ta forcuar kandidaturën për anëtarësim në të gjitha institucionet euroatlantike ashtu si edhe në Këshillin e Evropës. Chulick i bëri komentet të martën në një takim me një grup gazetarësh në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë. Ajo përsëriti se vizioni i ShBA-së për Kosovën është që ajo të jetë pjesë e institucioneve euroatlantike. “Ne i bëjmë thirrje Kosovës t’i dëgjojë këshillat e partnerëve të saj më të afërt në mënyrë që të garantojë një rezultat pozitiv kur del në një votim”, tha

Chulick. Gjatë vizitës në Kosovë, Chulick u takua me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, dhe me kryeministrin Albin Kurti. Ajo tha se u ka shprehur atyre disa shqetësime të partnerëve evropianë në lidhje me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe me Rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës, që e ndalon përdorimin e dinarit serb. “Kosova duhet të vazhdojë të punojë në këto çështje, t’i adresojë ato dhe të ecë sërish përpara”, tha zyrtarja amerikane. “Duke i ditur edhe përgjegjësitë që i ka Banka Qendrore e Kosovës, ne vazhdimisht i kemi shprehur shqetësimet tona për mënyrën e zbatimit [të rregullores]. Nuk kemi ndier se ajo e ka marrë në konsideratë mënyrën se si do t’i ndikojë komunitetet, sidomos komunitetin serb.

Ndaj jemi duke e vëzhguar situatën dhe jemi të shqetësuar”, shtoi Chulick. Kosova është në presion nga partnerët ndërkombëtarë për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, të dakorduar me Serbinë qysh në vitin 2013, si dhe për ta pezulluar Rregulloren e BQK-së që e bën euron valutë të vetme për pagesa me para të gatshme. Ndërkombëtarët kërkojnë më shumë kohë derisa komuniteti serb të përshtatet me praktikën e re, pasi ai, prej vitesh, ka pranuar pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia. Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i pranishëm në takimin me gazetarët, shprehu zhgënjimin e tij me aksionin e djeshëm të Policisë së Kosovës në veri të Kosovës, gjatë të cilit u mbyllën disa institucione financiare serbe. Hovenieri tha se ky veprim nuk ishte i koordinuar me partnerët ndërkombëtarë dhe, sipas tij, i përshkallëzon tensionet. Ai kërkoi nga Qeveria e Kosovës angazhim konstruktiv në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian, duke e cilësuar “si kanalin e duhur për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë”. Chulick, në anën tjetër, shtoi se një prej arsyeve përse gjendet në Kosovë, është për ta treguar

mbështetjen e ShBA-së për një Kosovë demokratike, të begatë dhe multietnike. Ajo theksoi se është e rëndësishme që Qeveria të angazhohet në mënyrë aktive me pjesëtarët e komuniteteve pakicë dhe t’i përfshijë ata në procesin e politikëbërjes. “Kosova është shtëpi e shumë serbëve etnikë dhe ata meritojnë t’i mbajnë familjet dhe bizneset e tyre këtu”, tha Chulick. Sipas saj, Qeveria e Kosovës duhet të punojë për të gjithë qytetarët e Kosovës, “pa marrë parasysh përkatësinë etnike apo dallimet e tyre”. Chulick tha, po ashtu, se ShBA-së i vjen keq që Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - nuk mori pjesë në votimin për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në komunat me shumicë serbe në veri më 21 prill. “Ne do të donim që ata të përfitonin nga mjetet demokratike që i kanë në dispozicion”, tha ajo. Chulick theksoi se ShBA-ja mbetet e shqetësuar nga trajtimi i pakicave në Kosovë dhe tha se do të vazhdojë të punojë në këtë çështje. Sipas saj, një nga përfitimet e të qenët pjesë e Këshillit të Evropës do të ishte “respekti më i madh për qytetarët e pakicave dhe qasja në procese ndërkombëtare përmes të cilave Kosova mund të adresojë çështje të tilla si: përfshirja e pakicave dhe pjesëmarrja e plotë në qeverinë dhe

demokracinë e vendit të tyre, për shembull, përmes Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”. Javën e kaluar Kosova mbeti jashtë agjendës së Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës - ku do të duhej të merrej vendimi përfundimtar për pranimin e saj - për faktin se nuk ndërmori hapa për ta çuar përpara çështjen e Asociacionit. E pyetur nëse druan se udhëheqësit nacionalistë në Ballkan do ta shfrytëzojnë vakumin politik ndërkombëtar, që rezultoi nga zgjedhjet në BE dhe në ShBA, për ta komplikuar më tej situatën në terren, zyrtarja e Departamentit Amerikan të Shtetit tha se “oportunistët politikë mund të përpiqen t’i shfrytëzojnë rrethanat ndërkombëtare në dobi të tyre në çdo kohë, por ne jemi vigjilentë ndaj atyre përpjekjeve jo vetëm këtu në Kosovë, por në mbarë botën. Është e rëndësishme për ne që të theksojmë se - janë interesa të sigurisë së ShBA-së dhe Evropës - ne mund të varem nga partnerët tanë dhe ata mund të varen nga ne, pa marrë parasysh partinë politike apo lëvizjen. Ne do të vazhdojmë të kontribuojmë për një Ballkan Perëndimor më të qëndrueshëm, më të sigurt dhe më të begatë dhe ne do të vazhdojmë të punojmë në mbështetje të këtij qëllimi”, përfundoi Chulick. (Rel)



Pranimi në KiE ‘mund ta ketë fatin si liberalizimi i vizave’

Nëse Kosova nuk bën hapa të menjëhershëm drejt formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, pritja e saj për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KiE) do të shndërrohet në një “sëmundje të gjatë” dhe me “kosto të lartë”, madje mund ta ketë fatin si liberalizimi i vizave

PRISHTINË, 21 MAJ - Nëse Kosova nuk bën hapa të menjëhershëm drejt formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, pritja e saj për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KiE) do të shndërrohet në një “sëmundje të gjatë” dhe me “kosto të lartë”, thotë Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane. Se a do të bëjë ndonjë hap në këtë drejtim, tash për tash nuk është e qartë. Interesimit të “Radios Evropa e Lirë” për këtë çështje nuk iu përgjigj as Qeveria e Kosovës, as Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës. Çështja e Asociacionit e la Kosovën jashtë agjendës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 17 maj, kur edhe do të vendosej për anëtarësimin e vendit në këtë organizatë. Kusht i disa vendeve anëtare të saj, përfshirë Francën dhe Gjermaninë, ishte që Kosova ta çonte së paku për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese një draft-statut të diplomatëve perëndimorë për Asociacionin. Vetëm 24 orë përpara se të mblidheshin ministrat e Këshillit të Evropës, ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika

Gërvalla, tha se vendi është duke përgatitur një draft-statut të vetin, bazuar në modelin e një organizate gjermane, për ta dorëzuar në Kushtetuese deri në fund të majit. Njoftimi i saj nuk i ndryshoi zhvillimet në KiE, sepse u konsiderua i vonshëm. Rrjedhimisht, Gërvalla tha se oferta e Kosovës “e humbi vetvetiu aktualitetin dhe relevancën”. “REL”-i e pyeti MPJD-në nëse kjo nënkupton heqjen dorë nga hartimi i draft-statutit, por nuk mori përgjigje. Shasha thotë se nëse Qeveria e Kosovës nuk e dërgon draft-statutin në Kushtetuese, siç u zotua, do të ketë pasoja për vetë Kosovën. Sipas tij, duke mos bërë hapa konkretë, vendi rrezikon të shkojë drejt një situatë të ngjashme me atë të vitit 2016, kur nuk e ratifikoi marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i Kosovës ishte kusht për heqjen e regjimit të vizave nga BE-ja për qytetarët e Kosovës. Për pasojë, thotë Shasha, Kosova i humbi gati 8 vjet, derisa siguroi

udhëtimin pa viza nga 1 janari i këtij viti. Ai thotë se situatë e ngjashme mund të ndodhë edhe me anëtarësimin në KiE - organizatën lidere në kontinent për të drejtat e njeriut. Për më tepër, shton ai, situata mund të ndikojë edhe në kredibilitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe ta ftojë atë edhe në proceset e tjera integruese. Formimi i Asociacionit, thotë Shasha, “është i pashmangshëm”. “Nga kjo punë, epilog tjetër s’ka. Siç thotë fjala popullore: ‘mund të ketë vonim, por shpëtim nuk ka’. Mund të provohet të bëhen të gjitha manovrat politike, por ikje nga përgjegjësia për ngritjen e Asociacionit nuk ka”, thotë ai. Për Belgzim Kamberin, nga Instituti për Politika Sociale “Musine Kokolari” në Prishtinë, Kosova tashmë e humbi rastin që u desh ta shfrytëzonte për anëtarësim në KiE. “Tash këtu kemi një lloj moskuptimi dhe kundërtënieje të thellë midis Quint-it [ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Francës dhe Italisë] dhe Qeverisë së Kosovës, lidhur me atë se për cilin draft-statut [të Asociacionit] po flitet”, thotë Kamberi për “Radion Evropa e Lirë”. Këtë, sipas tij, e dëshmon edhe fakti se Kosova nuk e dërgoi draft-statutin e Asociacionit në Gjykatë Kushtetuese edhe me koston e mospranimit në KiE. “...pra, nuk është e gatshme fare

Çfarë është Asociacioni?

Asociacioni, mes të tjerash, do ta koordinonte punën në arsim, kujdes shëndetësor dhe ekonomi në komunat me shumicë serbe të Kosovës. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për të qysh në vitin 2013. Marrëveshja u miratua edhe në Kuvendin e Kosovës, por Gjykata Kushtetuese konstatoi më pas se ajo ishte jokushtetuese, meqë nuk përfshinte etni të tjera. Pavarësisht prej garancive nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian, Kosova druan se një asociacion i tillë do të ndikonte në funksionimin e shtetit. Themelimi i Asociacionit u bë pjesë edhe e Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e arritur në vitin 2023.

Diplomatët perëndimorë e hartuan një draft-statut për këtë organ në fund të vitit të kaluar, por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nuk e ka pranuar. Javën e kaluar udhëheqësit e Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë bën me dije se i kanë dërguar një letër Kurtit, në të cilën i shprehën sërish mbështetje për draft-statutin e diplomatëve perëndimorë. Kurti, në letrën dërguar atyre, e la hapur mundësinë që ta shqyrtonte atë, por vetëm pasi të shqyrtohej fillimisht nga ekspertët ligjorë të KiE-së. Shefja e grupit parlamentar e partisë së tij - Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, tha të hënën në një intervistë për televizionin “Koha” në Prishtinë se ky draft “është i papranueshëm”.

ta themelojë Asociacionin ose po taktizon në kuptimin që për të [Qeverinë e Kosovës], themelimi i Asociacionit në këmbim me Këshillin e Evropës është ‘pazar i vogël’, thotë Kamberi pa specifikuar më shumë. Marrë parasysh zhvillimet në terren, njohësit e çështjeve politike, megjithatë, shprehen skeptikë për ndonjë hap të

shpejtë konkret në drejtim të themelimit të Asociacionit. Në Kosovë, gjithnjë e më shumë, është duke u diskutuar mundësia e zgjedhjeve të parakohshme. Bashkimi Evropian, po ashtu, është në fazën e procesit zgjedhor, në të cilën marrin pjesë aktive edhe disa prej figurave kryesore të institucioneve të BE-së.

Zgjedhje të parakohshme parlamentare gjatë verës?

Baraliu komenton situatën politike



PRISHTINË, 21 MAJ - Përkundër qëllimit që e kanë të njëjtë (rrëzimin e qeverisë Kurti), opozita ende nuk ka mundur të gjejë një kompromis për mënyrën se si ta dërgojë vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Tri subjektet opozitare, PDK, LDK dhe AAK, thonë se shtatori duhet të gjejë Kosovën me qeveri të re pasi, sipas tyre, qeveria e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti nuk ka shënuar asnjë sukses në fushën e brendshme e as të jashtme. Madje opozitarët deklarojnë se vendi po sanksionohet nga ndërkombëtarët pikërisht për shkak të veprimeve të kryeministrit. E gatshme për të shkuar në zgjedhje është edhe partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, por thotë se opozita duhet të ndërmarrë

veprime. Megjithatë, analisti politik Mazlum Baraliu, duke analizuar situatën politike në vend, thotë se, përkundër deklaratave për zgjedhje, as opozita dhe as pozita nuk janë të gatshme për zgjedhje. Sipas Baraliut, ka shumë faktorë që subjektet politike kanë hezitim të shkojnë në zgjedhje. “Pikërisht për shkak të interesave që janë të ndryshme të opozitës me partinë në pozitë, gjegjësisht koalicionin qeverisës dhe kalkulimet politike që bëhen të brendshme, përmes sondazheve të brendshme, përmes një mënyre e një tjetre - inspektimit thuajse të opinionit publik, përgjithësisht votuesve, veçanërisht votuesve potencialë të secilës parti - edhe më veçanërisht”, u shpreh ai për “Telegrafi”-n.

Njohësi i çështjeve politike dhe kushtetuese tha se partitë opozitare nuk janë sa duhet të sigurta se çfarë epilogu do të kenë zgjedhjet, pra se çfarë rezultati do të ketë në zgjedhjet e parakohshme. Baraliu pohoi se situata aktuale varet edhe nga takimi që kanë pasur përfaqësuesit e PDK-së me përfaqësuesin e qeverisë. “Varet se si janë marrë vesh në rastin e një takimi që kanë pasur përfaqësuesi i qeverisë me përfaqësuesit e Partisë Demokratike, meqë pamë një hap përpara në shtensionimin politik, pra në votimin e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare që janë të rëndësishme primare për Kosovën me vlera qindra milionësh, mbi treqind milionë dhe po shohim njëfarë lloj shtensionimi. Atëherë ka gjasa që mund të ketë ndonjë

marrëveshje edhe për zgjedhje, pra për një çelës të përbashkët, i cili mund të na çojë në zgjedhje të parakohshme”, nënvizoi ai. Baraliu në intervistë u shpreh se “ka mungesë të kurajës politike dhe sigurisë politike që të shkohet në zgjedhje”. “Madje do të thosha që edhe vetë koalicioni qeverisës ka disa përçarje ndoshta, të cilat pak a shumë për herë të parë dolën në sipërfaqe. Dhe opozita, po ashtu, është e shkapërdërdhur dhe kështu që nuk kemi ndonjë momentum të përshtatshëm për të pasur një unitet dhe një vendim të përbashkët po ose jo shpejt, sepse koha po ikën. Në qoftë se vonohen, këto afatet kushtetuese dhe ligjore do të veprojnë kundër këtyre interesave të subjekteve politike, atëherë po them se do të humbet momentum”, u shpreh

ai. Analisti Baraliu deklaroi se bazuar në zhvillimet e fundit, do të ishte më mirë që qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti të qëndrojë deri në fund të mandatit. “Unë mendoj se do të ishte më mirë për të gjithë që të mbetet në vijim mandati i kësaj qeverie që të shkohet deri në fund. Dhe ato pretime të cilat shumë nuk i ka përmbushur as kjo qeveri, sikurse edhe ato para saj, meqë ka projekte, është viti i fundit, është sezon e ndërtimeve, e punës, të shkohet deri në fund dhe për herë të parë do të ishte me rëndësi që në këtë çerekshkull te ne të kemi një qeveri, po edhe një legjislaturë, pra një Kuvend që e përfundon mandatin e plotë ligjor. Kjo do të ishte e rëndësishme, historike dhe shprehje e stabilitetit politik dhe parlamentar”, potencoi ai.

Edita Tahiri: Në vend se të ishte kryeministër i lekut, Kurti po bëhet 'kryeministër i dinarit'

PRISHTINË, 21 MAJ - Ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, e ka quajtur Albin Kurti “kryeministër të dinarit”.

Duke ia rikujtuar premtimin për bashkim kombëtar, ajo ka bërë me dije se Kurti do të duhej të bëhej kryeministër i lekut dhe jo i dinarit. Në

profilin e saj në “Facebook”, Tahiri ka shkruar se Kurti po hyn në histori si kryeministër i dinarit. “Kryeministri i dinarit. Në vend të ishte

kryeministër i lekut për të cilin premtoi dhe mori shumicën e votave - po hynë në histori për dinar”, ka shkruar Tahiri.



Hamza me ambasadorin Angili diskutojnë për investimet e reja turke në Kosovë

MITROVICË, 21 MAJ - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Turqisë, Tunç Angili, me të cilin ka biseduar për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes dy vendeve. “Një takim

produktiv bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Turqisë pata me ambasadorin Tunç Angili. Turqia është një partnere shumë e rëndësishme e Kosovës, e cila ka përkrahur gjithnjë forcimin e

subjektivitetit ndërkombëtar dhe zhvillimin tonë ekonomik. Ne biseduam edhe për investime të reja turke në Kosovë dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes dy vendeve”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.



Hapet edicioni i 8-të i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove “Prishtina International Theatre Festival 2024”



Prishtinë, 21 maj - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri Hajrulla Çeku morën pjesë në ceremoninë hapëse të edicionit të 8-të të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në Prishtinë “Burbuqe Berisha”, në Teatrin “Faruk Begolli” në Kolegjin AAB.

Në fjalën hapëse kryeministri përmendi realizimin me sukses të Ligjit të ri për Kulturë, i cili ka reformuar tërë legjislacionin në kulturë me standardet dhe punën kërkimore më të lartë në bashkëpunim dhe konsultim mbi dyvjeçar me aktorët vendorë e ata ndërkombëtarë, duke theksuar se efektet e tyre do t'i shohim edhe në aspektin afatgjatë, ku për teatrot

zvogëlohet burokracia, rriten mundësitë dhe hapen dyert e bashkëpunimit edhe më shumë. Në kuadër të kësaj ceremonie Kurti dhe Çeku vizituan edhe ekspozitën e fotografit Artan Humolli, me titull “AJO”, me të cilën ka fituar disa çmime ndërkombëtare.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe drejtori i Festivalit Prishtina International Theatre Festival 2024, Zijad Mehić, ambasadori i Shqipërisë, Petrit Malaj, ai i Malit të Zi, Bernard Çobaj, rektori i AAB-së, Blerim Olluri, themeluesi i AAB-së - poeti Lulzim Tafaj, përfaqësues të institucioneve kulturore, artistë dhe artdashës, profesorë, mësime dhe studentë.

Kërkohet nxitje e mbështetjes financiare për të rinjtë dhe gratë në biznes

GJILAN, 21 MAJ - Është mbajtur debati i parë në Gjiilan me temën “Ndërmarrësia gjithëpërfshirëse dhe rritja ekonomike: Nxitja e mbështetjes financiare lokale për të rinjtë dhe gratë në biznes”. Nën kryetarija e komunës së Gjiilanit, Leonora Morina-Bunjaku, ka folur në emër të

kryetarit Alban Hyseni në “Javën e debateve për politikën e gruas”. Debati është organizuar në bashkëpunim me komunën e Gjiilanit, NDI Kosova me mbështetje të USAID-it dhe Ambasadës Zvicerane. Folëse ishte edhe drejtoresha e NDI-së, ambasadorja Nancy Soderberg.

Derisa u bisedua lidhur me ndërtimin e aftësive, fokus ishte edhe strategjia lokale kundër dhunës me bazë gjinore. Ndërsa në panel diskutimi ka folur edhe drejtoresha e Buxhetit dhe Financave, Herolinda Murati-Leka, ku u theksua edhe nxitja e mbështetjes financiare lokale për të rinjtë dhe gratë në biznes.



Latifi mban dëgjimin e parë publik për planifikim të hershëm të buxhetit për vitin 2025

RAHOVEC, 21 MAJ - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur dëgjimin e parë publik për planifikim të hershëm të buxhetit për vitin 2025. Latifi ka bërë me dije se pasi i informuan dhe dhanë sqarime për të pranishmit, për tërë atë që përmban qarkorja e parë buxhetore e ardhur nga MF-ja për komunën e Rahovecit, bashkëbiseduan edhe

për ecurinë e përgatitjes së KAB-it komunal 2025-2026. “Me drejtorin për financa dhe buxhet, drejtorët e tjerë të drejtorive komunale si dhe me grupin punues për hartimin e buxhetit, me vëmendje kemi dëgjuar për shqetësimet, nevojat dhe kërkesat nga të rinjtë, pensionistët, gratë dhe komunitetet pakicë”, ka bërë me dije Latifi.


Osmani kujton masakrën e Stagovës

Prishtinë, 21 maj - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar 25-vjetorin e masakrës së Stagovës. Ajo ka theksuar se 25 vjet më parë forcat paramilitare të

regjimit gjenocidal të Serbisë, në fshatin Stagovë të Kaçanikut, vranë 13 banorë të fshatit. “Në këtë ofensivë barbare, forcat kriminale shkatërruan 90 shtëpi nga

180 sa kishte fshati atëkohë. Ende askush nuk është dënuar për këtë krim makabër, ndaj nuk do të ndalemi në angazhimin për vendosjen e drejtësisë dhe

për të pasur kuptim liria jonë. Qoftë i përhershëm kujtimi dhe nderimi për të gjithë të rënë për liri”, është thënë në deklaratën e Osmanit.



Mbahet takimi për sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional, diskutohet me donatorë kryesorë


Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar të martën një takim me grupin punues së bashku me përfaqësues të donatorëve në zbatimin e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë.

Kryeministri Kurti cilësoi se gjatë tri viteve të qeverisjes është theksuar vazhdimisht rëndësia e lidhjes së arsimit me ekonomi dhe të arsimit dhe aftësimin profesional me tregun e punës.

Tashmë kur gjendemi në vitin e dytë akademik të zbatimit të arsimit dual, janë gjithsej 12 profile në 23 shkolla profesionale në 14 komuna të Kosovës në të cilat janë të përfshirë 920 nxënës. "Arsimi dhe aftësimi profesional janë themelore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Pajisja e fuqisë punëtore me aftësi praktike dhe të përshtatshme na lejon ta adresojmë drejtpërdrejt hendekun e aftësive në industritë kyçe, duke çuar në rritjen e produktivitetit, inovacionit dhe të konkurrencës në tregjet lokale dhe globale", u shpreh ai.

Në kuadër të zbatimit të sistemit dual, kryeministri njoftoi se



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, së bashku me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kanë punuar me përkushtim për t'i bërë reformat e nevojshme për ta lidhur arsimin me nevojat aktuale dhe ato të ardhshme të tregut. Po ashtu, në bashkëpunim me donatorë sikurse GIZ, ADA, SDC, USAID,

LuxDev, KfW dhe BE, janë kryer sondazhe dhe hulumtime për t'i identifikuar nevojat dhe për t'i përcaktuar mënyrat më të mira se si t'i plotësojmë ato.

Gjatë kësaj punëtorie, aktorët e përfshirë diskutuan përpilimin e standardeve të reja për profilet e mësimin dual, bazuar në propozimet e MINT-it dhe kërkesat e tregut të punës.

Çështje tjetër ishte edhe zhvillimi i burimeve njerëzore që nevojiten në industri për mbarrëvajtjen e këtij sistemi, respektivisht trajnimi i instruktorëve për zbatimin e sistemit dual.

Një nga çështjet kryesore për t'u diskutuar dhe zhvilluar ishte dhe ajo mbi provimet gjatë aftësimin profesional dhe certifikimi në fund të procesit. "Bashkëpunimi

mes shkollave të mesme dhe të ulëta, shkollave të arsimit dhe trajnimit profesional dhe sondazhet mbi efektivitetin e mësimin dual nga perspektiva e studentëve, mësimdhënësve, bizneseve, dhomave dhe shoqatave të biznesit, janë thelbësore për suksesin e kësaj nisme tonë të përbashkët", përfundoi ai.

Arratisja e Enver Sekiraqës, Kurti thotë se ka dështuar sistemi gjyqësor

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e 206 të kabinetit qeveritar ka folur për arratisjen e Enver Sekiraqës. Ai ka theksuar se arratisja e personit përgjegjës për vrasjen e Triumf Rizës është dështim i sistemit tonë gjyqësor, që vazhdon të arratiset vetë nga drejtësia. "Në fundjavën që po e lëmë pas, kuptuam që një prej personave më famëkeq nga bota e krimit, i cili javën e kaluar u dënua përfundimisht nga gjykata me 25 vjet burgim për vrasjen e Triumf Rizës, policit të Kosovës, është arratisur. Të gjithë atë që e kanë njohur Triumfin, e përshkruajnë njëzëri si profesionist të pasiq, të shkathtë në detyrë e shumë njerëzor me qytetarë. Triumfin e kam takuar edhe unë dhe kam po këtë përshtypje. Arratisja e



personit përgjegjës për vrasjen e tij, Enver Sekiraqës, është dështim i sistemit tonë gjyqësor, që vazhdon të arratiset vetë nga drejtësia. Edhe më e rëndë bëhet

situata kur këso rastesh nuk përbëjnë më përjashtim, nuk ngajnë më si rastësi", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se Qeveria e

Kosovës angazhohet për çdo ditë, për t'i përfshirë të gjithë qytetarët, nga të gjitha komunitetet pa dallim, në jetën institucionale, zhvillimin

ekonomik, drejtësinë sociale të Republikës sonë të përbashkët. "Vendosja e rendit dhe ligjit është kusht i domosdoshëm për arritjen e këtij synimi. Këtë nuk e bëjmë kundër askujt të posaçëm. Këtë e bëjmë gjithnjë për të gjithë. Për interesin publik në Republikë demokratike. Shteti i së drejtës dhe sundimi i ligjit janë dhe duhet të jenë qëllim dhe përkushtim i shtetit, me gjyqësorin e mirë, që drejtësinë dhe ligjin i bën sinonime në përshtypjen e qytetarëve dhe të shoqërisë mbarë. Vrasësit e policëve në liri janë kulmi i padrejtësisë. Reforma në drejtësi që dikur ishte nevojë, tash është urgjencë. Urgjencë institucionale. Urgjencë shtetërore. Urgjencë kombëtare", ka thënë kryeministri Kurti.

Pas Kroacisë, edhe Bullgaria do të dërgojë 100 ushtarë në Kosovë

Prishtinë, 21 maj - Bullgaria do të dërgojë një kontingjent prej 100 ushtarëve në Kosovë në kuadër të KFOR-it. Dislokimi, sipas agjencisë bullgare të lajmeve "Novinite", shënon një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e NATO-s për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në rajon.

Ceremonia e dërgimit të kontingjentit ushtarak në


Kosovë do të mbahet në sheshin Georgi Izmirliov në Blagoevgrad. Ata do të zbarkojnë në Kosovë në javën e vijim.

Kontingjenti përbëhet kryesisht nga Komanda e Brigadës së Tretë në Blagoevgrad, e cila do të dislokohe për operacione me Forcën e Stabilizimit të NATO-s në Kosovë (KFOR).

Kontingjenti bullgar do të

angazhohet në aktivitete që synojnë t'i mbështesin përpjekjet për rivendosjen dhe ruajtjen e sigurisë në Kosovë.

Aktualisht, Bullgaria ka rreth 48 ushtarë në Kosovë. Ky numër do të rritet në rreth 150. KFOR-i në Kosovë ka gjithsej 4 443 trupa nga 28 vende. Numri i trupave është rritur që nga tensionet e majit të vitit të kaluar.



Shuhet ndërmarrja publike NKEC

PRISHTINË, 21 MAJ - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur të martën ka marrë vendim për shuarjen e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës (NKEC). Kryeministri Albin Kurti ka thënë në mbledhjen e qeverisë se kanë pushuar shkaqet për ekzistimin e ndërmarrjes e cila u themelua në vitin 2018 për projektin e ndërtimit të një

termocentrali të ri. Ministri e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se bodri i drejtorëve e përgatiti shpërbërjen e ndërmarrjes dhe se kjo ndërmarrje nuk është duke e zhvilluar veprimtarinë për të cilën është themeluar ose ndonjë veprimtari tjetër komerciale për një kohë. Kjo ndërmarrje prej vitesh

ishte pa funksion, por vetëm brenda vitit 2022 ia ka harxhuar buxhetit të shtetit afër 100 mijë euro në paga për shtatë anëtarë të saj. Ndërmarrja NKEC ishte themeluar për ta menaxhuar kontratën e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” nga “Contour Global”, por ky projekt është anuluar që nga marsi i 2020-s.



ShBA-ja kritikon ashpër mbylljen e degëve të bankës serbe në veri të Kosovës

PRISHTINË, 21 MAJ - Departamenti Amerikan i Shtetit shprehu zhgënjimin për mbylljen nga Policia e Kosovës të gjashtë njësive të “Bankës Postare Kursimore” të Serbisë në veri të vendit, duke thënë se “ky veprim nuk ishte i koordinuar me partnerët ndërkombëtarë” dhe se ai “përshkallëzon tensionet”. “Ai (veprimi) minon perceptimin se Kosova po vepron me vullnet të mirë për zgjidhjen e çështjeve mes saj dhe Serbisë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja”, tha një zëdhënës i Departamentit të Shtetit, duke iu përgjigjur interesimit të “Zërit të



Amerikës”. Zëdhënësi vë në dukje se “Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka kërkuar vazhdimisht koordinim

ndërmjet qeverive tona” në mënyrë që ta mbështesë përpunimin e Kosovës në rrugën e saj euroatlantike, përfshirë së fundmi “nga nënsekretarja e

shtetit Elizabeth Allen në takimin e saj me kryeministrin Kurti më 19 maj”. Departamenti i Shtetit përsëriti shqetësimin e Shteteve të

Bashkuara lidhur me masat e Bankës Qendrore të Kosovës për kufizimet mbi përdorimin e dinarit serb.

Banka Postare Kursimore është institucioni që ka shpërndarë pagesat e Beogradit për qytetarët serbë në Kosovë. Policia e Kosovës tha se operacioni për mbylljen e njësive të kësaj banke u krye në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës dhe se synimi ishte “vendosja e rendit dhe ligjshmërisë”, duke e quajtur Bankën Postare Kursimore në veri të vendit, ilegale.”

8.5 milionë euro subvencion për sektorin e bletarisë



PRISHTINË, 21 MAJ - Mbështetja e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për sektorin e bletarisë përmes subvencioneve dhe granteve arrin në 8.5 milionë euro. Kështu ka bërë me dije përmes një njoftimi për medie Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas njoftimit, ministri i BPZHR-së, Faton Peci, me rastin e shënimit të “Ditës Botërore e Bletës”, ka vizituar bletarin Bajram Bajrami nga fshati Berivojc i komunës së Kamenicës, i cili ka 700 koloni të bletëve, në rreth 400 koshere, të shpërndara në 13 parqe të ndryshme. Gjatë vizitës në veprimtarinë e këtij bletari, ministri Peci ka parë nga afër se në këtë fermë plotësohet zinxhiri i vlerës nga prodhimi dhe përpunimi i produkteve dhe nënprodukteve të mjaltës deri edhe te përpunimi i helmit të bletës si një ndër produktet kyçe për përdorim në mjekësi. “Bletarinë si një ndër sektorët më me potencial në vend po e mbështesim përmes subvencioneve dhe granteve, duke ndikuar në këtë mënyrë zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie bujqësore”, ka thënë Peci. Po ashtu, ai theksoi se ashtu siç bletët punojnë në grup dhe për të mirën e përgjithshme të kolonive, ashtu edhe ne si shoqëri duhet ta ndjekim shembullin e tyre drejt krijimit të politikave zhvillimore në favor të fermerëve tanë dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Aliu: Në qershor përfundon harta e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet

PRISHTINË, 21 MAJ - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se në qershor përfundon harta e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet bashkë me planin për reagim. Aliu në një konferencë për medie të martën ka thënë se me kapacitetet aktuale e me ndryshimet klimatike nuk po arrijnë t'i menaxhojnë lumenjtë. “Kosova i ka katër pellgje lumore. Pellgu i Drinit të Bardhë është pellgu më i madh. Janë draftuar ligjet për menaxhimin e këtyre pellgjeve. Kosova është një vend që ka kapacitete të limituara të ujit. Jemi në një krizë. 75 për qind të këtij uji e përben vetëm liqeni i Ujmanit. Në të ardhmen duhet t'i rrisim këto kapacitete sepse kemi ndryshime që shpeshherë nuk mund t'i menaxhojmë mirë për shkak të mungesës së planeve. Jemi në qershor dhe e



përfundojmë hartën e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet bashkë me planin për reagim. Duke pasur parasysh që një vendim i tillë si ky sot, ne kemi themeluar edhe task-forcën e gjelbër, jemi duke ndërmarrë hapa konkretë për mbrojtjen e ambientit. Gjatë këtyre ditëve kemi pasur aksion të vazhdueshëm, për eksploataime të zhavorrit në lumenj dhe janë bërë konfiskime të pajisjeve dhe ky aksion do të vazhdojë”, ka thënë ai.

Dogana e Kosovës konfiskon 4 000 copë detergjent të falsifikuar

PRISHTINË, 21 MAJ - Dogana e Kosovës ka konfiskuar rreth 4 000 copë detergjent “Ariel” i cili është i falsifikuar. “Dogana e Kosovës, pas pranimit të konfirmimit nga

bartësit e të drejtave, ka konfiskuar mallin e falsifikuar, preparate për larje dhe pastrim në sasi rreth 4 000 copë. Sipas dispozitave ligjore në fuqi,

mallrat e falsifikuar nuk lejohet të dalin në qarkullim të lirë, është bërë me dije në njoftimin për medie. Dogana e Kosovës ka theksuar se është e

përkushtuar maksimalisht për luftimin e falsifikimit dhe piraterisë dhe si rezultat i zbatimit efektiv të të drejtave të pronësisë intelektuale.



Për Bubulinën apo për heroinën?



Nga: Çapajev GJOKUTAJ

Javën që kaloi, në një apo dy media “online”, më saktë në katakombet e tyre, d.m.th. në pjesën e rezervuar për komente anonimësh, u zhvillua një farë diskutimi për Laskarina Bubulinën, heroinën greke me origjinë arbërore. Diskutohej përkatësia e saj, arvanitase apo greke, ua dhamë fqinjëve jugorë apo na e rrëmbyen etj., gjëra të këtij lloji që zakonisht nga anonimët e mediave “online” përcillen me shumë emocion dhe pak logjikë, me sharje, kërcënime, përbetime e të tjera qasje tribale të këtij lloji.

Që një grup krejt heterogjen njerëzish të arrijë të diskutojë sidokudo dhe me njëfarë frytshmërie për personalitete të tilla, duhet që paraprakisht të bien dakord për kë do të diskutojnë, për personazhin real historik apo për heroin, në rastin tonë: për Bubulinën apo për heroinën që është krijuar e mbështetur në jetën dhe bëmat e saj. Stërhollime dhe sofizma intelektualësh, do të thoshte shumëkush, por kushdo që ka njohuri sado të pakta nga teoritë e pasqyrimin e të riprodhimit, e di se heronjtë janë konstruktive sociale, që do të thotë se ata janë individë, të cilët një shoqëri zgjedh t'i lartësojë si burime frymëzimi dhe admirimi. Natyrisht, këto konstruktive

ngrihen mbi persona dhe ngjarje realhistorike, por procesi i sendërtimit të tyre përfshin një përzierje të saktësisë faktike, idealizimit, interpretimit etj.. Heronjtë krijohen e riprodhohen jo për hir të historisë, po për hir të së sotmes. Prej personit real merren tipare që i shërbejnë aktualitetit apo interesave të kësaj apo asaj pale dhe lihen mënjatë të tjera që mund të krijojnë pështjellim a të prishin punë.

Duke konstruktuar e rikonstruktuar Bubulinën si heroinë të revolucionit grek, fqinjët tanë jugorë nuk kanë qenë të interesuar të theksojnë origjinat e saj, as të humbasin në morinë e hamendjeve sesi ndihej ajo, ç'identitete njihte si të vetat: arvanitase, greke, ortodokse, vllahe, nënshetase otomane etj. Heroina e krijuar prej grekëve (jo Bubulina reale që mund t'i ketë njohur e pranuar disa nga identitetet që porsa përmendëm) duhej të ishte dhe është puro greke, madje shumë më greke sesa grekët e zakonshëm, që për dy shekuj e kanë mbajtur gjallë në kulturën e tyre. E përsëris jo se kështu ndihej vërtet, po se kështu e donin dhe e duan interesat shoqërore e politike të ditës, dekadës a shekullit. Epo, mirë, mund të thotë shumëkush, Bubulina e konstruktuar prej fqinjëve tanë

jugorë ka identitetet puro grek; Bubulina e konstruktuar prej nesh ka identitetet arvanitas që e lidh me trojet arbërore ku jetonin stërgjyshërit e saj, pra edhe me ne shqiptarët e sotëm. Edhe kështu mund të jetë, vetëm se heroina jonë, ajo me identitetet arvanitas, është shumë më e zbehtë sesa heroina që kanë konstruktuar grekët.

Kjo jona ekziston dhe riprodhohet në disa studime njerëzish patriotë dhe dijetarë të ndershëm dhe prej andej na viziton jo dhe aq shpesh, për të mos thënë rrallë, vetëm kur njërit apo tjetrit i duhet të ndërtojë narrativa të tipit: revolucionin grek e bënë shqiptarët, gratë tona janë burrëresha, pse shqiptarët bëhen të shquar në dherra të tjera kurse këtu mbeten mediokër e brekëgrisur etj. Mund të rendisësh edhe të tjera narrativa të këtij lloji, por pothuajse të gjitha të kujtojnë fishekzjarrët që hidhen një herë në mot.


Tjetër gjë kanë bërë grekët me Bubulinën e tyre. Kanë dy shekuj që në mënyrë të vazhdueshme e thuajse të përditshme e mbajnë të gjallë mes të gjallëve. Shteti grek i ka dhënë gradën e kundëradmiralit, duke e bërë gruan e vetme në botë që mban këtë gradë. Të bën përshtypje se ky gradim është bërë para gjashtë vjetësh, më 2018 dhe vetëkuptohet se nuk është bërë

për Bubulinën, as për pasardhësit e saj, as thjesht për të rritur krenarinë e grekëve bashkëkohorë, por është bërë edhe (apo sidomos) për interesa biznesi që lidhen me turizmin dhe flotën, dy nga industritë më të mëdha të fqinjit tonë jugor. Irenë Papas e ka përjetësuar në filmin 'Bouboulina' prodhimin vitit 1959, kurse para dy dekadash tërhoqi vëmendjen një dokumentar i goditur për të. Para daljes së euros e hasje portretin e saj në disa prerje të dhrahmisë greke. Në vise të ndryshme të Greqisë has shtatore e sidomos buste të saj, ashtu siç ka dy a tre muze, dhjetëra vepra letrare, jeta dhe bëmat e saj janë bërë prej kohësh pjesë e kurikulave shkollore, shëmbëlltyra e saj të shfaqet jo rrallë në murale, kur viziton Greqinë etj.

Kjo diferenca mes asaj që bëjmë ne për Bubulinën tonë dhe asaj që kanë bërë e bëjnë grekët për të tyren të kujton anekdotën e atyre dy fqinjëve, që pasi gjetën një thesar nën gardhin që ndante bahçet e tyre, e ndanë në dy pjesë të barabarta, por të barabartë nuk u bënë se njeri e investoi në disa sipërmarrje, kurse tjetri e mbylli në qyp dhe e fshehu diku në haur. I pari e shtoi pjesën që i ra, i dyti e pakësoi me kalimin e kohës se sa herë kishte nevojë merrte disa florinj nga qypi thjesht për të shlyer shpenzimet.

Çdo metaforë çalon, përfshirë dhe këtë të qypit, ndaj shumëkush mund të hidhej e të thoshte se grekët kanë investuar e investojnë kaq shumë në krijimin dhe qarkullimin e Bubulinës, ngaqë bëmat e saj, përpjekjet dhe sakrificat që bëri, kanë qenë në dobi të Greqisë. Dhe, kjo tingëllon e vërtetë po problemi ynë me Bubulinën do parë si simptomë e një sëmundjeje a dukurie më të gjerë.

Si shpjegohet që sot e kësaj dite nuk kemi një panteon me heronj të pranuar thuajse nga gjithë shqiptarët këtu në trojet amtare a në diasporë. Ç'emër t'i vësh faktit që edhe për kryeherin e kombit tonë, Skënderbeun, po bëhen përherë më të pranishme në rrjete sociale dhe më gjerë dilema të tipit: ishte kështjellar i qytetërimit perëndimor dhe kalorës i krishterimit, apo ishte sahanlëpirës i venetikave dhe bukëshkalë i sulltanëve osmanë? Të tilla teza paçka se nuk kanë asnjë vlerë shkencore dhe mbase edhe kulturore, paçka se nuk prekin asnjë fije floku të kryeheroit, dëshmojnë se kohezionin kombëtar nuk e kemi dhe aq rozë sa e pandehim. Por, në të njëjtën kohë dëshmojnë se duhen strategji e politika shumë më të përpunuara e largpamëse, që shohin në të sotmen, të nesërmen e të pasnesërmen e zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Granit Xhaka në ekipin e vitit në Gjermani

LEVERKUSEN, 21 MAJ - Mesfushori Granit Xhaka ka bërë një rikthim sensacional në Bundesligë. Pasi kishte shkëlqyer me Borussia Monchengladbachun vite më parë, ylli kosovar e bëri të njëjtën gjë edhe në këtë edicion

me Bayer Leverkusenin, duke u shpallur kampion i Bundesligës. Faqja e specializuar për transfere dhe vlerësime të lojtarëve, "Transfermarkt", e ka përfshirë Granit Xhakën në ekipin ideal të sezonit në Bundesligë.

Kampioni gjerman vlerësohet 20 milionë euro, ndërsa e gjen veten përpara mbrojtjes ideale. 31-vjeçari i ka zhvilluar 33 ndeshje në Bundesligë, me ç'rast i ka shënuar tre gola. Gjithashtu, Xhaka ka mundësi ta fitojë edhe Ligën e Evropës,

ku në finale do të përballlet me Atalantën. Aty futbollisti luftarak i ka zhvilluar 10 ndeshje dhe i ka dhuruar dy asistime. Formacioni: Kobel, Fimpong, Anton, Tah, Grimaldo, Xhaka, Simons, Wirtz, Musiala, Kane, Guirassy.



Ballkani kërkon trofeun e parë të Kupës, Prishtina daljen në Evropë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MAJ - Kampioni i ri i Superligës së Kosovës në futboll, Ballkani, po synon të bëjë ligjin në futbollin e Kosovës, pasi sot (e mërkurë) synon ta fitojë Kupën, që i mungon në sirtar. Klubi i drejtuar nga Ilir Daja ka shkëlqyer në garat ndërkombëtare, e ka fituar Superkupën, e ditë më parë e festoi titullin e tretë të kampionit dhe tash po synon edhe një sukses tjetër për sezonin 2023/2024. Për të arritur këtë synim, klubi nga Suhareka duhet ta mposhtë në finalen e madhe skuadrën me të trofeshme në Kosovë, Prishtinën.

Klubi i Ballkanit një ditë para finales ka shkrua në faqen zyrtare, ku ka paralajmëruar se do të ketë një shfaqje tjetër të madhe. "Kampionët e Republikës së Kosovës zbresin sërish në fushë edhe për një

shfaqje tjetër të madhe. Jemi vetëm një ditë para finales së Kupës së Kosovës. Është koha edhe për një hap tjetër të rëndësishëm. Të motivuar si gjithmonë, në stadiumin 'Rexhep Rexhepi' në Drenas, shkojmë për të luftuar me vetëmohim që trofeu i Kupës së Kosovës të vijë në Suharekë. Faleminderit të gjithë tifozëve anembanë Shqiptarisë që në vazhdimësi u qëndroni pranë kampionëve! Edhe kësaj radhe, si gjithmonë, bashkë jemi më të fortë", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Klubi kryeqytetas nuk ka pasur formë të mirë në kampionat, por në Kupë po synon ta përsërisë suksesin e vitit të kaluar, njëherësh ta sigurojë edhe pjesëmarrjen në garat evropiane. Prishtina do ta zhvillojë finalen e 12-të dhe do ta kërkojë triumfin e 9 në Kupë. "Të mërkurën zhvillohet finalja e 30 jubilarë e Kupës së Republikës që nga viti



1993. FC Prishtina e zhvillon finalen e 12, duke synuar trofeun e 9. Vetëm fitorja e dërgon Prishtinën në Evropë. Ndeshja zhvillohet në stadiumin 'Rexhep Rexhepi' në Drenas nga ora 15:00. Tribuna jugore është e ndarë për tifozët tanë, 'Plisat', ndërsa biletat për tribunën lindore shiten te

stadiumi. Tribuna veriore është e rezervuar për tifozët rivalë, ndërsa tribuna perëndimore e rezervuar për FFK. FC Prishtina për këtë ndeshje është e kompletuar. Nga lista e gjerë mungojnë vetëm Kreshnik Uka dhe Altin Gjokaj", thuhet në njoftimin e kryeqytetasve.

Finalja në mes të Ballkanit dhe Prishtinës zhvillohet në Drenas nga ora 15:00, kurse do të gjykohej nga gjyqtari Genc Nuza, i cili do të asistohet nga Granit Hyseni dhe Arbnor Bullatofci, derisa gjyqtar i katërt do të jetë Ilir Mehmeti.



Trepça - Ylli, rruga drejt finales

Mitrovicë, 21 maj - Trepça dhe Golden Eagle Ylli do të përballen në finalen e pestë të "play-off"-it, ku do të vendoset se kush do të shpallet kampion i Kosovës. Mitrovicasit në edicionin e rregullt përfunduan në vendin e parë me 25 fitore e tri humbje, kurse therandasit në vendin e tretë me pikë të barabarta me Pejën që ishte e dyta me 19 fitore e

nëntë humbje. Trepça në gjysmëfinale eliminoi Sigal Prishtinën 3:0, derisa Golden Eagle Ylli në çerekfinale mundi Bashkimin 2:0 dhe Pejën në gjysmëfinale 3:2. Në garat e rregullta të elitës, të dyja skuadrat kishin nga dy fitore ndaj njëra-tjetrës, derisa mitrovicasit triumfuan edhe në Ligën Unike ndaj therandasve dhe në gjysmëfinale të Kupës.

Në "play-off", seria finale është 2:2, ku të dyja skuadrat shënuan fitore si vendas. "Xehetarët" fituan 77:68 dhe 85:78, derisa therandasit fituan 80:79 dhe 75:71. Finalja e pestë që zhvillohet të enjten mbrëma do të vendosë se kush do ta fitojë titullin. Ylli e ka fituar dy herë, më 2021 dhe 2022, kurse Trepça më 1993, 2000, 2001 dhe 2012.

Grumbullim treditor i Kosovës U19 në Kampin Nacional në Hajvali

PRISHTINË, 21 MAJ - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në futboll ka nisur të martën grumbullimin në kuadër të përgatitjeve për dy miqësoret kundër Shqipërisë, që do të zhvillohen në Rogozhinë, në stadiumin "Egnatia Arena", më 6 dhe 9 qershor. Grumbullimi do të zgjasë tri ditë

dhe do të zhvillohet në Kampin Nacional në Hajvali. Përzgjedhësi i kësaj grupmoshe, Adil Maliqi, ka në dispozicion në këtë grumbullim 23 futbollistë vendorë. "Ky grumbullim ka një rëndësi të veçantë për përzgjedhësin Maliqi, i cili do të shfrytëzojë këto ditë për ta vlerësuar formën aktuale të

futbollistëve dhe për të punuar në komponimin e ekipit për turnetë e ardhshme. Trajneri ka si synim të ndërtojë një ekip të fortë dhe konkurrues", thuhet në njoftimin e FFK-së. Futbollistët e përzgjedhur theksuan se këto grumbullime janë një mundësi e shkëlqyer për ta përmirësuar lojën e tyre.



Shefi i McLarenit: Po të kishte edhe dy xhiro Lando do ta parakalonte Verstappenin

IMOLA, 21 MAJ - 63 xhirot e garës së Çmimit të Madh të Imola në Formula 1 nuk i mjaftuan McLaren për të fituar këtë garë. Piloti britanik Lando Norris u klasifikua i dyti, vetëm 7 të dhjetat pas Max Verstappen. Norris iu afrua shumë

holandezit në xhirot e fundit, duke përfutur nga problemet me gomat që kishte makina Red Bull. Drejtori sportiv i McLarenit, Zak Brown, u shpreh se nëse gara do të zgjaste edhe dy xhiro më shumë, parakalimi do të kishte

ndodhur. “Mendoj se Lando do ta kishte fituar garën nëse do të kishte edhe dy xhiro më shumë në dispozicion. Max po pilotonte në limite, duke shfrytëzuar gjithë baterinë dhe tregoi se është një kampion”, ka thënë Brown. “Me dy xhiro më

shumë do të kishim një mundësi për parakalim. Gjithsesi, jam i kënaqur nga gara e Imolas, çka konfirmon se jemi në rritje dhe se fitorja në Majemi nuk ishte rastësi. Kemi një dyshe konkurruese pilotësh”, ka deklaruar shefi i McLarenit.



Kroosi konfirmon pensionimin pas ‘Euro 2024’

MADRID, 21 MAJ - Mesfushori gjerman Toni Kroos ka marrë vendimin e papritur duke u tërhequr nga futbolli i luajtur. Bëhet me dije se ai ka vendosur t'i japë fund karrierës së tij si futbollist profesionist pas “Euro 2024”. “17 korrik 2014, dita e prezantimit tim në Real Madrid, dita që më ndryshoi jetën. Jeta ime si futbollist, mbi të gjitha si njeri. Ishte fillimi i një jete të re në klubin më të madh në botë. Sot, pas 10 vitesh, në fund të sezonit, kësaj jete i vjen fundi. Nuk do ta harroj kurrë këtë dekadë emocionuese dhe të suksesshme! Dëshiroj të falënderoj veçanërisht presidentin Florentino Perez, klubin dhe të gjithë ata që më pritën me zemër të hapur dhe më besuan. Por, mbi të gjitha, dua t'ju falënderoj, të dashur tifozë të Real Madridit, për dashurinë dhe mbështetjen tuaj nga dita e parë deri në të fundit. Në të njëjtën kohë, ky vendim do të thotë që karriera ime si futbollist aktiv do të përfundojë këtë verë pas Euros”, ka thënë Kroos. “Siç e kam thënë gjithmonë, Real Madridi është dhe do të jetë klubi im i



fundit. Sot jam i lumtur dhe krenar që gjeta në kokën dhe zemrën time momentin e duhur për këtë vendim. Ambicia ime ishte gjithmonë ta përfundoja karrierën time në nivelin më të lartë. Nga ky

moment, kam vetëm një mendim kryesor në mendjen time dhe asgjë nuk do të më ndajë nga kjo: Le të shkojmë për 15!!! Hala Madrid dhe asgjë më shumë!”, ka deklaruar Kroosi.

Slot: Oferta e Liverpoolit nuk refuzohet

LIVERPOOL, 21 MAJ - Arne Slot u konfirmua zyrtarisht trajneri i ardhshëm i Liverpoolit të hënën pasdite, me holandezin që vjen si pasues i Jurgen Kloppit. 45-vjeçari largohet nga Feyenoordi, ku kaloi tre vjet dhe fitoi titullin e Eredivisie dhe Kupën e Holandës. Slot ende nuk ka dhënë intervistën e tij të parë zyrtare si menaxher i Liverpoolit pasi puna e tij nis zyrtarisht më 1 qershor. Megjithatë, ai dërgoi një mesazh të shkurtër për Feyenoordin dhe tifozët e tyre, të postuar në faqen zyrtare të klubit holandez. “Sigurisht që nuk është një vendim i lehtë të mbyllësh derën në një klub ku ke përjetuar kaq shumë momente të mrekullueshme dhe ke punuar me sukses me kaq shumë njerëz të mrekullueshëm”, ka thënë Slot.



“Por si sportist, një mundësi për t'u bërë trajner në Ligën Premierë, në një nga klubet më të mëdha në botë, është e vështirë të injorohet. I jam mirënjohës Feyenoordit për gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në këtë tranzicion. Dhe si një tifoz futbolli, sigurisht

se do të vazhdoj ta ndjek klubin, jo vetëm sepse jam i bindur se ka ende shumë gjëra të mëdha për të ardhur në Rotterdam. I uroj Feyenoordit dhe të gjithë atyre që kujdesen për këtë klub të mrekullueshëm gjithë të mirat për të ardhmen”, ka përfunduar Slot.

Dybala, jashtë Kupës së Amerikës

Argjentina nuk do ta grumbullojë për Kupën e Amerikës, Paulo Dybalën. Lajmi po qarkullonte prej disa ditësh në mediet amerikano-latine, teksa trajneri

Lionel Scaloni e kishte lënë jashtë sulmuesin e Romës edhe në listën paraprake. Megjithatë, mendohej se e gjitha lidhej me aspektin fizik të Dybalës që, së

fundmi, hasi në disa dëmtime. Por, nga Argjentina e bëjnë të sigurt se e vetmja arsye që “La Joya” ka përfunduar jashtë liste është zgjedhja taktike e Scalonit.

Pra, Dybala nuk është jashtë kombëtares për shkak të kondicionit fizik, por sepse para tij preferohen sulmues të tjerë teksa kjo i është komunikuar

edhe vetë 30-vjeçarit. Kujtojmë se Kupa e Amerikës do të startojë më 21 qershor me Argjentinën që është fituesja në fuqi dhe i duhet ta mbrojë “fronin”.

SHKURT

Martinezi: Asllani është e ardhmja, më ka habitur

Lautaro Martinez, kapiten i Interit, mendon se Kristjan Asllani është lojtari i së ardhmes për zikaltrit. Në një intervistë të fundit, argjentinasi zbuloi bisedën në fillimin e sezonit me mesfushorin e kombëtares së Shqipërisë, duke i dhënë atij një këshillë shumë të vlefshme. “Interi është shtëpia ime, kështu jam ndier nga dita e parë në Milano. I detyrohem gjithçka shoqërisë dhe tifozëve zikaltër, ta ngrija trofeun si kapiten ishte e jashtëzakonshme. Skuadrës i kam thënë që në fillim që një kapiten ka nevojë për të gjithë, dhe ata më kanë mbështetur gjithnjë. Një shembull? Në fillimin e sezonit fola me Asllanin dhe i thashë se duhej të ‘gjallërohej’ pak, të bënte më shumë. Nuk më foli për disa ditë, por pastaj më falënderoi. Ai ka gjithçka për të qenë lojtari i së ardhmes”, ka deklaruar Lautaro.

Kane mund të rikthehet në Angli, kërkohet nga Chelsea

Harry Kane mund të rikthehet sërish në Premierë Ligë. Sipas raportimeve më të fundit të medieve britanike, bordi i Chelseat po monitoron situatën e qendërsulmuesit anglez te “bavarezët” me shpresën për ta arritur transferimin e tij në afatin kalimtar të verës. Kane nuk është i lumtur në Bayern pavarësisht 37 golave dhe 12 asistimeve të realizuara në 35 paraqitje sezonale, prandaj ideja e Chelseat është të hyjë në një negociatë të mundshme me “Uraganin”, që konsiderohet si numri 9 ideal për t'i zgjidhur problemet ofensive të trajnerit Pochettino, i cili e “dashuron” stilin e lojës së Kanes.

De Gea refuzon ofertën e Nottinghamit

Portieri spanjoll David De Gea vazhdon të jetë ende pa klub edhe pas nëntë muajsh pasi i skadoi kontrata me Manchester Unitedn. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ai ka marrë oferta të ndryshme nga skuadra të ndryshme, edhe pse asnjëra nuk ka arritur ta bindë spanjollin. Propozimi më i fundit erdhi nga Nottingham Forest, megjithatë ai e ka refuzuar këtë ofertë, me arsyetimin se nuk i ka përmbushur pritshmëritë e tij. Një tjetër klub i Premierligës që shfaqti interesim në dhjetor ishte Newcastle, pas lëndimit afatgjatë të portierit anglez Nick Pope, megjithëse në fund nuk u finalizua asnjë marrëveshje. Destinacioni i De Geas mund të jetë Saudi Pro League, ku klubet si Al Hilali e Al Nassri e kanë kontaktuar ish-portierin e Kombëtares së Spanjës.

Bayerni kërkon dy yjet e Milanit

Mike Maignan dhe Theo Hernandez, dy nga titullarët më të rëndësishëm të Milanit, janë në dyshim të fortë në lidhje me të ardhmen. Të dy lojtarët kanë kontratë edhe për dy vitet e ardhshme, por “gjelat” francezë kërkojnë kushte të reja, përmirësim të pagës aktuale. Për t'ua bërë edhe më të vështirë punën drejtuesve të Milanit po mendon Bayern Munchen, me klubin gjerman që është vënë në ndjekje të dy lojtarëve. Bayern sheh te Maignan portierin ideal për ta zëvendësuar Neuerin, ndërsa te Theo Hernandez anësin ideal për ta zëvendësuar Alphonso Davies.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “36 VIP Dyner Pasha 06” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812010528 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “36 VIP Dyer Pasha 06” D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812010528 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “36 VIP Dyner Pasha 06” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812010528 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook 

www.facebook.com/giejpuneshpeite

RESTAURANT



SWISS TAVERNA



Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitore Fazliu, shpall të pavlefshme INDEX-in, e Fakultetit të Prishtinës, drejtimi Juridik me nr. R-107/08.
- Rron Zogaj shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme të lartë "Mehmet Akif" Colege, Prishtinë si dhe certifikatën e notave.
- Sahit Biraj shpall te pavlefshme 2 dëftesat Q.K. "11 Marsi " Prizren.
- Arso Ajkovic shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Egzona Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.
- Hasime Berisha Rogovë KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. "Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë.
- Gresë Dervishi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Lorik Mataj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhemdin Nixha" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

